

LIGJ
Nr.7558, datë 9.4.1992

**PËR DISA NDRYSHIME E PLOTËSIME NË LIGJIN NR.7491, DATË 29.4.1991 “PËR
DISPOZITAT KRYESORE KUSHTETUESE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 28 pika 4 dhe 30 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”;

Me propozimin e grupit prej një të katërtës së deputetëve

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 17 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Veprimtaria e Kuvendit Popullor merr fund ditën e mbledhjes së parë të Kuvendit të ri”.

Neni 2

Në nenin 25, bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Presidenti i Republikës zgjidhet nga Kuvendi Popullor për pesë vjet, pa debat, me votim të fshehtë dhe me një shumicë prej dy të tretash të votave të të gjithë deputetëve. Në rast se në votimin e parë nuk sigurohet shumica e kërkuar, bëhet botimi i dytë në të cilin Presidenti zgjidhet me shumicën absolute të votave të të gjithë deputetëve”.

Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Kandidati për President propozohet nga një grup deputetësh prej jo më pak se 20 vetësh”.

Pas paragrafit të dytë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Një deputet nuk lejohet të marrë pjesë në më shumë se në një grup deputetësh që propozojnë kandidatin për President”.

Neni 3

Në nenin 26, paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Funksioni i Presidentit të Republikës është i papajtuashëm me çdo funksion tjetër shtetëror, përveç atyre të parashikuara në këtë ligj, dhe me atë të kryetarit të partisë”.

Neni 4

Në nenin 28, pas pikës 4 shtohet pika 4/a me këtë përmbajtje:

“I propozon Kuvendit Popullor për të vendosur për referendume populllore”.

Neni 5

Në nenin 28, pika 5 ndryshohet si vijon:

“Ka të drejtë, me mesazh të motivuar, brenda 15 ditëve nga miratimi i ligjit prej Kuvendit Popullor, t’ia kthejë këtij për rishqyrtim vetëm një herë”.

Neni 6

Në nenin 28, pika 7 ndryshohet si vijon:

“Me propozim të Kryetarit të Këshillit të Ministrave, emëron, shkarkon ose liron me dekret ministra dhe anëtarë të tjerë të veçantë të Qeverisë. Këtë dekret Presidenti i Republikës ia paraqet për miratim Kuvendit Popullor, brenda 10 ditëve”.

Neni 7

Në nenin 28, pas pikës 7 shtohet pika 7/a me këtë përmbajtje:

“Në raste të veçanta, ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe të propozojë në rendin e saj të ditës çështje të cilat çmon se duhet të shqyrtohen. Kur merr pjesë në mbledhje e drejton atë dhe firmos vendimet e marra.”

Neni 8

Në nenin 28, në pikën 8, në fund, shtohen fjalët:

“... kryetarin dhe zëvendëskryetarët e SHIK-ut”.

Neni 9

Në nenin 28, pas pikës 8 shtohet pika 8/a me këtë përmbajtje:

“Kërkon mendim dhe të dhëna me shkrim nga drejtues të institucioneve të pushtetit ekzekutiv për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre”.

Neni 10

Në nenin 28 pika 10 ndryshohet si vijon:

“Lidh traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare, ratifikon dhe denoncon ato që nuk i shqyrton vetë Kuvendi Popullor”.

Neni 11

Pas pikës 18 të nenit 28 shtohet pika 18/a me këtë përmbajtje:

“Komunikon me Kuvendin Popullor nëpërmjet mesazheve, të cilat lexohen në seancë plenare”.

Neni 12

Pas nenit 32, shtohet neni 32/a me këtë përmbajtje:

“Presidenti i Republikës mund të krijojë pranë tij organizma këshillimorë me karakter ndihmës”.

Neni 13

Në nenin 36, pas pikës 1 shtohet pika 1/a me këtë përmbajtje:

“Realizon udhëheqjen e përgjithshme të administratës shtetërore”.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.